



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AVOKATI I POPULLIT**

RAPORT

Problematikat e komunitetit Rom gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2012, dhe trajtimi i tyre nga Avokati i Popullit.

Tiranë, Korrik 2012

I.Hyrje

Shqipëria, është në një moment të rëndësishëm të procesit të integritit në Bashkimin Europian dhe në këtë kuadër institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se reformat që duhet të ndërmerren nga institucionet e shtetit shqiptar, duhet të jenë të përqasura me standardet më të mira ndërkombëtare, duke garantuar në këtë mënyrë zbatimin e parimeve demokratike të shtetit të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut.

Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë personave që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë: shqiptarë, pjesëtarë të pakicave kombëtare, të huaj apo persona pa shtetësi.

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, një ndër prioritetet e punës së tij, ka dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom. Përmbyshja e detyrimeve, që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, me qëllim që ky komunitet të jetojë me standartet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, kërkon koordinim ndërinstitucional, me rëndësi thelbësore për mbrojtjen më efektive të të drejtave të komunitetit Rom. Avokati i Popullit thekson se zgjidhjet e problemeve të këtij komuniteti nuk janë as të lehta, as të thjeshta dhe as të shpejta. Ato janë pjesë integrale, të lidhura pazgjidhshmërisht me zhvillimin tërësor të Shqipërisë, pra edhe me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë.

“Kushtet e varfëra të jetesës dhe situata e pafavorizuar sociale e banoreve rom që jetojnë në Shqipëri, janë problem që po u kushtohet vëmendje nga strukturat qevritare si dhe opinion publik. Treguesit socialë për popullsinë rome janë konsideruar më të ulët se mesatarja kombëtare dhe një pjesë e madhe e minoritetit rom jeton më mes të kushteve të pasigurta, të pambrojtur dhe nën nivelin mesatar të jetesës”¹.

“Nje karakteristikë e komunitetit rom është jeta jostabile e tyre në vendbanime të qëndrueshme. Pasojat që sjell kjo lëvizje e herëpashershme krijon problem

¹“Gjëndja sociale dhe ekonomike e romeve”-Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”, miratuar me VKM nr.633 date 18.09.2003.

për këtë popullsi si dhe për vetë shtetin. Ndryshimi i ambjentit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë në tjetrën, vështirësitë për t'u ripunësuar dhe integrimi me jetën në një tjetër ambjent, ka pasoja nga më të ndryshmet”².

Në këtë kontekst institucioni i Avokatit të Popullit po monitoron në vazhdimësi respektimin e të drejtave dhe lirive të romëve në Shqipëri, apo masat që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore përgjegjëse, për garantimin e plotë të tyre, në zbatim të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale.

II. Problematikat dhe rekomandimet për përmirësimin e kushteve të jetesës të pjesëtarëve të komunitetit Rom:

Për periudhën Janar-Qershor 2012 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre 106 pjesëtarë të komunitetit rom, si dhe janë filluar për shqyrtim me iniciativën tonë 2 raste. Problematikat e ngritura, të vlerësuara nga ana jonë, bazuar në shqyrtimin e këtyre rasteve kanë patur të bëjnë kryesisht lidhur me: çështjen e strehimit, të mospërfitimit të ndihmës ekonomike, punësimit, etj.

Moszgjidhja e çështjes së strehimit.

Të gjithë ankuesit janë shprehur se jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike, duke mos plotësuar asnjë nga nevojat minimale të jetesës së përditshme. Shumica e tyre jeton nëpër baraka, ndërsa disa të tjerë nuk kanë asnjë strehë. Pretendimi i ankuesve ka qëndruar në faktin se, megjithëse kanë vite që jetojnë në Tiranë, nuk kanë mundur të zgjidhin problemin e strehimit të tyre, pavarësisht kërkesave të herspashërshme dhe dorëzimit të dokumentacionit pranë Bashkisë Tiranë.

Duke e konsideruar çështjen e tyre si mohim i të drejtës për strehim, që i bëhet kësaj shtrese të shoqërisë, ata iu drejtuan Avokatit të Popullit, i cili vendosi pranimin e ankesave dhe fillimin e hetimit të kësaj çështje, duke ndërmarrë procesin e ndërmjetësimit me Bashkinë Tiranë. Pas shqyrtimit të kërkesave të tyre, kemi kërkuar, që pas verifikimit të listës emërore të pjesëtarëve të komunitetit Rom, të informoheshim lidhur me qëndrimin e Bashkisë, për mundësinë e përfshirjes së tyre në programet sociale të strehimit.

² *Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom”*

Nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social pranë Bashkisë Tiranë, na janë dhënë sqarime, lidhur me trajtimin e bërë. Nga të dhënat që dispononte Bashkia Tiranë, rezultoi si me poshtë:

- 50 ankues nuk figuronin të regjistruar në programin elektronik si të pastrehë. Kjo kategori duhej që t'i drejtohej njësisë vendore ku janë të regjistruar, me qëllim plotësimin e formularit të strehimit.

- 20 ankues kane plotësuar formularin e strehimit pranë njësisë bashkiake dhe duhej të vijonin me fazën e dytë të aplikimit, që lidhet me dorëzimin e dokumentacionit sipas programit të përgjedhur.

- 31 ankues kanë aplikuar për fazën e dytë dhe më pas është Këshilli Bashkiak, si organ vendimarrës, i cili do të vendosë për qytetarët fitues.

Pas kësaj korrespondence, kemi kthyer përgjigjet përkatëse sipas grupeve të sipërcituara, ku i kemi sugjeruar për rrugën që duhet te ndjekin, sipas problematikave.

Lidhur me strehimin dhe problematikën me të cilën ndeshet komuniteti rom theksojmë se ligji 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

Ligji ka pësuar disa ndryshime në vite, ndërkohë që ndryshimi i bërë gjatë vitit 2012, ka sjellë ndryshime thelbësore në përmbajtjen e tij. Sipas pikës 1 të nenit 4 të ligjit përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) nuk kanë në pronësi një banesë;
- b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;
- c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Ndërkohë, sipas pikës 2 të këtij neni, përfshihen në një të njërit nga shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1, vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të neneve 6 e 19 të këtij ligji.

Në nenin 5 të ligjit 9232/2004 (i ndryshuar), përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së familjeve duke parashikuar një sërë kushtesh, ndërmjet të cilave edhe kushtet sociale. Në gërmën "c", ku trajtohen edhe kategoritë që kanë përparësi sipas këtij kushti, konstatojmë se nuk janë përfshirë familjet e komunitetit rom. Mendojmë se përfshirja e tyre si kategori prioritare brenda këtij kusht, mund të rriste nivelin e pikëve të tyre, duke dhënë shpresë për përfitimin e strehimit. Ndërkohë për kushtin "gjendja ekonomike", ligji nuk ka parashikuar kategori prioritare.

Gjithashtu, sipas nenit 6, pika 1 e ligjit 9232/2004 (i ndryshuar) për nivelin e të ardhurave theksohet se jo më pak se 80 për qind e familjeve që trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura, deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, ndërkohë që pjesa tjetër mund të përzgjidhet brenda intervalit 100 - 120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare. Kjo kategori e fundit sipas ligjit paguan një qira më të lartë se kategoritë e tjera, por jo më shumë se 30 për qind të të ardhurave mujore.

Mbështetur në sa më sipër një familje romë nëse është brenda njërit prej kategorive të përcaktuara në nenin 4, të ligjit 9232/2004 (i ndryshuar), nëse do të duhet të përfitojë një strehim, duhet të ketë të ardhura deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

Nga përcaktimi i sipërpërmendur i ligjit është e vështirë të përcaktohet se çfarë kuptohet me të ardhura "...deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.", pra këtu do të hyjnë edhe familjet që kanë 20% të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse? Për më tepër dispozita nuk ka deleguar rregullimin me një akt nënligjor të kësaj çështje, duke lënë në këtë mënyrë një formulim i cili mund të passjellë në qëndrime subjektive dhe abuzive të njësisë së qeverisjes vendore, gjatë vlerësimit të plotësisë të këtij kriteri.

Pavarësisht se në nenin 24 të ligjit është parashikuar se kur qiraja e banesës sociale zë më shumë se 25 për qind të të ardhurave neto të familjes, sipas shkronjës "a" të nenit 5 të këtij ligji, kjo e fundit përfiton subvencionim të

qirasë, dhe ndërkohë familjet komunitetit rom kanë përparësi në subvencionimin e qirasë ose përfitimin e bonusit të strehimit, përsëri vlerësojmë se parashikimet e ligjit nuk do të mund të garantojnë në praktikë strehimin e familjeve të komunitetit rom. Argumentet në të cilat mbështetet ky vlerësim janë:

a. Familjet e komunitetit rom, pjesa problematike e tyre, e kanë të vështirë të provojnë një nivel të ardhurash mujore (pasi kryesisht punojnë në të zezë);

b. Edhe nëse ato e kanë të mundur të provojnë të ardhurat e tyre (të ardhura nga pagat nëse do të jenë të punësuar, të ardhura nga ndihma ekonomike), niveli i tyre mund të mos jetë në përqindjen e përcaktuar të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

Mbi sa më sipër mendojmë që ligji duhet të kishte parashikuar rregullime më të qarta, për familjet e komunitetit rom.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke patur në konsideratë të gjithë problematikën me të cilën përballlet komuniteti rom, si dhe duke qenë se një numër i madh ankuesish nuk janë të regjistruar në njësitë e qeverisjes vendore në Tiranë, dhe si rezultat nuk kanë akses në përfitimet ligjore, më datë 09.04.2012, ka dërguar Rekomandimet e mëposhtme:

1-Rekomandim Ministrit të Brendshëm, Z.Bujar Nishani:

Duke marrë shkas nga ankesat e shumta që kanë ardhur pranë institucionit tonë nga pjesëtarë të komunitetit Rom, kemi konstatuar se mungesa e informacionit apo dhe neglizhenca e indiferentizmi i tyre, ka bërë që në shume raste këta shtetas të mos figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre.

Regjistrimi i tyre do të bënte të mundur aksesin në përfitimet ligjore. Shumica e familjeve romë nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, nuk përfitojnë të ardhurën nga papunësia, nuk mund të aplikojnë për të përfituar nga programet sociale të banesave, si dhe shumë të drejtave, që gezojnë pjesa tjetër e popullsisë. Mospërfitimi i këtyre të drejtave vjen si pasojë e mosregjistrimit të tyre në gjendjen civile, si dhe për shkak të lëvizjes së vazhdueshme nga një vend në tjetrin. Nga ankesat e tyre, rezulton se shumë familje romë janë vendosur në Tiranë prej shumë vitesh dhe nuk janë përfitues të të drejtave ligjore, pasi nuk

figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre, por figurojnë në gjendjet civile të komunave apo bashkive të tjera. Bazuar në kriteret e vendosura në aktet nënligjore, që një familje romë të regjistrohet në qytet, duhet që ajo të përmbushë kriteret e percaktuara në aktet nënligjore, njeri prej të cilëve është edhe patja e një banese në pronësi apo me qira. Për familjet e komunitetit rom është e pamundur që të kenë një banesë në pronësi, apo me qira. Mosplotësimi i këtij kriteri sjell për pasojë mosregjistrimin apo transferimin e tyre nga një njësi e qeverisjes vendore në një tjetër.

Në mbështetje të nenit 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”, duke sanksionuar kështu barazinë pa asnjë lloj diskriminimi të të gjithë shtetasve që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit 2010-2015, lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit Rom të paregjistruar, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe aksesin në shërbime, *Rekomanduam:*

Marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin e ri.

Në përgjigje të këtij rekomandimi jemi informuar nga Ministria e Brendshme se komuniteti Rom, ashtu si çdo shtetas shqiptar, gëzon të njëjtat të drejta si në çdo fushë dhe në atë të shërbimit të gjëndjes civile. Sipas Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet të gjitha rrugëve ligjore, është e angazhuar për të regjistruar dhe ata fëmijë, të cilët për arsye nga më të ndryshmet, prindërit e tyre nuk i kanë regjistruar në shërbimin e gjëndjes civile. Me ngritjen e Regjistratit Kombëtar të Gjëndjes Civile, është lehtësuar dhe shpejtuar procedura e ndryshimit të vendbanimit. Shtetasit duhet të paraqiten pranë nëpunësit të shërbimit të gjëndjes civile ku kërkon të shkojë në vendbanimin e ri me të gjitha dokumentat e duhura ligjore dhe në moment nëpunësi i shërbimit të gjëndjes civile kryen veprimet për ndryshimin e vendbanimit. Kjo procedurë e miratuar siguron dhe sanksionon barazinë pa krijuar asnjë lloj diskriminimi për të gjithë shtetasit që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Pavaresisht lehtësirave të ofruara për të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë, Avokati i Popullit, këmbëngul se në mungesë të një informacioni

apo për shkak dhe të indiferentizmit të disa pjesëtareve të komunitetit Rom, mbetet një çështje ende e pazgjidhur regjistrimi i këtyre familjeve në vendbanimin e ri, pasojë e së cilës, siç e theksuam me lart është mospasja akses në përfitimet ligjore.

2-Rekomandim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z.Myqerem Tafaj:

Nga ankesat e paraqitura pranë Institucionit tonë nga pjesëtarë të komunitetit Rom, konstatoam se shumica e tyre ishte e pashkolluar ose vetëm me arsimin fillor, si dhe që fëmijët nuk ndiqnin shkollën.

Një fushë e rëndësishme e zbatimit të të drejtave të fëmijës është arsimit dhe shkolla. Arsimiti i pjesëtarëve të këtij komuniteti, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikasë për integrimin e tyre të plote në shoqëri. Niveli i ulët arsimor është problem serioz, që pengon integrimin e këtij komuniteti me shoqërinë. Shumica e fëmijëve romë janë analfabetë, dhe kjo për shkak të vështirësive gjuhësore që kanë fëmijët në klasë të parë, të gjëndjes tejte të vështirë ekonomike të familjeve të tyre, të largesisë që kanë me vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore si dhe të mentalitetit të gabuar të prindërve.

Karakteristikat e jetesës të familjeve romë kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës dhe mundësitë janë shumë më të kufizuara se pjesa tjetër e popullësisë dhe si rezultat, sjellin një pamundësi ekonomike për të përballuar jetesën si dhe një sërë problemesh sociale.

Lëvizja e shpeshtë e tyre, nga një vendbanim në tjetrin, ka bërë që ata të mos përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale shtetërore, e për më tepër fëmijët e këtij komuniteti, jo vetëm që kanë braktisur bankat e shkollave, por dhe shfrytëzohen në rrugë për të lypur e për punë të rëndomta.

Ligji nr.7952 datë 21.06.1995 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, ka sanksionuar të drejtën e barabartë të shtetasve të Republikës së Shqipërisë për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimimit parauniversitar, pavarësisht nga gjëndja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjëndja shëndetësore dhe niveli ekonomik.

Sa më lart, me qëllim arsimimin e vazhdueshëm e me prioritet të pjesëtarëve të komunitetit Rom, bazuar në parimin kushtetues, se kushdo ka të drejtën për

arsimim, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 1 të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, në të cilën përcaktohet se: “*Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikpamja e dinjitetit dhe e të drejtave*” si dhe të nenit 10 të Ligjit nr. 7952 datë 21.06.1995 “Per arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka përcaktuar se “Për të mundësuar një pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, shteti krijon kushte që personat e pakicave të moshës madhore të mësojnë gjuhën shqipe, historinë dhe kulturën shqiptare”, *Rekomanduar*:

Marrjen e masave për ngritjen e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve Romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit Rom për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, informohemi se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka një plan të detajuar veprimi për përfshirjen me prioritet të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopshte dhe shkolla. Është rishikuar dhe buxhetuar “Plani i veprimit për arsimimin e fëmijëve romë” dhe për realizimin e tij, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore raportojnë periodikisht në MASH.

Gjatë periudhës në vazhdim institucioni i Avokatit të Popullit, do të kërkojë shpjegime dhe informacion nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të dhëna statistikore konkrete për përfshirjen e fëmijëve romë në kopshte dhe shkolla.

3.Rekomandim drejtuar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Z.Spiro Ksera

Për komunitetin Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore, kërkohet një bashkëpunim dhe një ndërgjegjësim i tyre për të drejtat dhe rrugën që duhet të ndjekin për t’i realizuar ato.

Një pjesë e madhe e popullsisë rome në moshë pune, vuajnë papunësinë. Disa prej tyre, kryesisht merren me punë të rëndomta, por edhe kjo mënyrë e fitimit të të ardhurave për mbijetesë, është e përkohshme. Prandaj, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom dhe të Planit të Kombëtar të Veprimit 2010-2015, del si një çështje imediate punësimi i pjesëtarëve të minoritetit rom, në përshtatje me kërkesat

bashkëkohore të tregut të punës. Kjo do të sillte një përmirësim të gjendjes ekonomike të familjeve dhe integrimin e tyre në shoqëri si dhe do të garantonte shanse të barabarta.

Gjithashtu, duhet siguruar edhe përfshirja sociale e minoritetit Rom në Shqipëri si një komponent i Strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim.

Sa më lart, duke qenë se Ligji Nr.7795 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, në pikën “20” të nenit 2, ka parashikuar detyrimin e përfshirjes së minoritetit Rom në programet e nxitjes së punësimit, si grupe të veçanta punëkërkuese, gjithashtu Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.48 datë 16.1.2008 “Për masën dhe kriteret nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi”, në pikën 3 gërma “e”, ka përcaktuar si punëkërkuës të papunë në vështirësi edhe pjesëtarët nga komuniteti Rom, si dhe me qëllim plotësimin e një prej objektivave sociale të shtetit shqiptar, sanksionuar në germen “a” të nenit 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: punësimi në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë, rekomanduam:

Marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit Rom në programet e formimit profesional dhe punësimin në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

Në përgjigje të këtij rekomandimi informohemi se Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë nisma konkrete për hartimin e politikave nxitëse dhe lehtësuese për komunitetin Rom, me synim nxitjen e punësimit të tyre si dhe kualifikimin, trainimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Kjo politikë ka qenë gjithmone një prioritet edhe në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom”. Në vitin 2011, në krahasim me vitin 2010, numri i punëkërkuësve të papunë nga ky komunitet është rritur me 10 %, shifër kjo që tregon ndërgjegjësimin e tyre për t’u paraqitur pranë zyrave të punësimit dhe për të përfituar nga shërbimet e ndryshme, që ofrohen vecanërisht për grupet e veçanta, ku bën pjesë edhe komuniteti Rom.

Aktualisht zbatohen 2 programe, që kanë prioritet punësimin e punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta:

1. VKM nr.48 datë 16.01.2008 “Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë, në vështirësi”. Sipas këtij programi punëdhënësit që punësojnë me kontratë njëvjeçare punëkërkes të papunë ne vështirësi, mund të përfitojnë një financim për një vit, në masën 100% të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të kontributit të punëdhënësit; një financim për katër muaj në masën 100% të pages minimale në shkallë vendi. Në kategorinë e punëkërkesve të papunë në vështirësi sipas këtij programi, konsiderohen edhe personat nga komuniteti Rom
2. VKM nr.27 datë 11.01.2012 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”. Ky program synon të nxisë drejtuesit dhe menaxheret shqiptare të bëjnë përpjekje për të punësuar punëkërkes të papuna femra nga grupet e veçanta. Kjo mbështetje konsiston në financimin e masës së detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe katër paga minimale në shkallë vendi, ku në femrat nga grupe të veçanta bëjnë pjesë edhe femrat romë.

Në Urdhërin nr.782 datë 04.04.2006 “Për tarifën e sistemit të formimit profesional”, i ndryshuar, është parashikuar që tarifën e regjistrimit për punëkërkesit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit dhe që duan të ndjekin kursin profesional të formimit profesional, të ofruara nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik janë falas për grupet e veçanta, ku përfshihen edhe punëkërkesit e papunë romë.

Sipas të dhënave statistikore të tregut të punës në vite për punëkërkesit e papunë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilat na janë dërguar, konstatohet se në vitin 2011 numri i punëkërkesve të papunë romë dhe egjiptianë të regjistruar në Zyrat Rajonale të Punësimit ka qenë më i lartë se në vitin 2010. Konkretisht në vitin 2010 ka qenë 6970, ndërsa në vitin 2011 ka qenë 7666. Janë trajnuar pranë qendrave publike falas në vitin 2011, 217 persona, nga 62 të trajnuar në vitin 2010.

Pavaresisht, kërkesave në rritje nga komuniteti rom, për rregjistrim si punëkërkes të papunë pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, Avokati i Popullit konstaton se numri i punëkërkesve të papunë rom, të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit në vitin 2011 është ulur në krahasim me

2010. Konkretisht në vitin 2011 numri ka qenë 6 persona, krahasuar me 2010, ku numri ka qene 28 persona. ³

III. Raste të filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit

Duke marrë shkas nga situata e krijuar si rezultat i largimit nga vendstrehimi i përkohshëm i disa familjeve romë, të vendosura në Babrru, Tiranë, Institucioni i Avokatit të Popullit, filloi shqyrtimin me iniciativë të trajtimit të këtij rasti me datë 01.02.2012.

Duke qenë se kushtet e vështira klimaterike të atyre ditëve të ftohta, temperaturat e ulta që priteshin të vazhdonin në ditët në vijim, bënë emergjente marrjen e masave në ndihmë të kategorive të tjera të popullsisë, si personat endacakë apo të pastrehë, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikonin jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve.

Në këto kushte i Rekomandua **Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, z.Alfred Olli si dhe Kryetarëve të Bashkive dhe Kryetarëve të Keshillave Bashkiake** në të gjithë vendin:

“Marrjen e të gjitha masave të mundshme organizative për përgatitjen e vendstrehimeve apo vend-qendrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente, si pjestarë të komunitetit rom, personave endacakë apo të pastrehë dhe këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e pushtetit vendor, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve”.

Vijojmë ta konsiderojmë se kjo çështje duhet të trajtohet me përparësi nga ana e autoriteteve vendore, për të marrë në vazhdimësi masat e duhura, me qëllim që të paraprihen situata të vështira jetësore, të cilat mund të ndodhin në stinën e dimrit gjatë vitit kalendarik në vazhdim, apo edhe në vitet e ardhshme. Në këtë kontekst vlerësojmë se autoritetet vendore duhet të hartojnë plane veprimi dhe ndërhyrje afatmesme, për parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen. Këto plane masash duhet të parashikojnë veprime dhe ndërhyrje konkrete,

³ Sipas të dhenave të derguara bashkëngjitur me shkresën e MPCSSHB në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit

institucionet apo autoritete përgjegjëse për realizimin e tyre, afatet për plotësimin e tyre, burimet e nevojshme financiare etj.

IV.Problematikat e konstatuara për 8 (tetë) familjet e komunitetit Rom, të cilët janë transferuar ne ambientet e ish Repartit Ushtarak në Sharrë, Kombinat.

Nga data 1 shkurt e vitit 2012, për 12 ditë me radhë, 8 familjet e komunitetit rom me 59 anëtare mes të cilëve 30 fëmijë nga mosha 0-7 vjeç u strehuan në kushte emergjence në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit. Këto familje ishin paralajmëruar për dëbim nga zona ku kishin ngritur çadrat e tyre brenda datës 01.02.2012. Pas konstatimit të situatës së rëndë, Avokati i Popullit premtoi strehimin e drejtpërdrejtë të tyre në ambientet e institucionit, nëse shteti nuk gjente zgjidhje në përshtatje me kushtet e tyre të emergjencës.

Menjëherë pas sistemimit të familjeve rome në institucionin e Avokatit të Popullit, mbërritën dhe ndihmat nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat të koordinuara me njëra-tjetrën kanë ndihmuar me ushqim, veshmbathje dhe ilaçe këto familje gjatë këtyre ditëve. Organizatat që ndihmuan në kalimin e kësaj situatë emergjence ishin: Eorld Vision, Terre des Hommes, SFI, CRCA, Alo 116, TLAS, Kryqi i Kuq Shqiptar etj. Po kështu dhe nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit Publik u kryen rregullisht vizita mjekësore për fëmijët. Gjatë kohës së qëndrimit të 8 familjeve rome në ambientin e institucionit, Avokati i Popullit bëri përpjekje të vazhdueshme për të gjetur një zgjidhje, kjo edhe në kuadër të zbatimit të masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Minoritetin Rom dhe për Planin e Veprimit për Dekadën e Romëve.

Krahas 8 familjeve që u strehuan në kushte emergjence në datën 1 shkurt 2012 brenda zyrave të Avokatit të Popullit, një numër i konsiderueshëm familjesh rome erdhi në datën 3 shkurt 2012 në mjediset e këtij institucioni. Këto familje i shprehën Avokatit të Popullit shqetësimin se kanë të njëjtat probleme me 8 familjet e strehuara në ambientet e tij. Avokati i Popullit vuri në dispozicion të tyre të gjithë personelin e zyrës duke kryer këshillimin, marrjen e ankesave dhe identifikimin e kategorive dhe problemeve ligjore të cilave ata ju përkisnin.

Familjet rome të cilat u strehuan në zyrat e Avokatit të Popullit në kushte emergjence që nga datën 1 shkurt 2012 u larguan mesditën e datës 12 shkurt dhe u strehuan në ambientet e “Romani Baxt Albania”. Këto familje të pastreha

qëndruan në mjediset e vëna në dispozicion nga kjo shoqatë deri në përfundimin e punimeve në ambjentin e paracaktuar për ta nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, ambjente të cilat sipas kësaj ministrie, do të ishin gati pas një muaji. Gjatë kësaj periudhe organizata “Romani Baxt Albania” u mbështet me fonde nga Fondacioni Vodafone Albania. Pas një qëndrimi rreth 3 mujor në qendrën “Romani Baxt Albania”, 8 familjet rome, nën kujdesin e Ministrisë së Punës dhe të shoqëruar nga forca policie në datën 8 maj 2012, janë shoqëruar në ambientet e një ish- reparti ushtarak në zonën e Sharrës.

Në vijim të impenjimit institucional sa i përket zgjidhjes përfundimtare të problemit të strehimit të 8 familjeve të komunitetit rom, të cilët në muajin Shkurt u strehuan pranë Institucionit të Avokatit të Popullit dhe më pas në Qendrën e shoqatës “Romani Baxt Albania”, ekspertë të Avokatit të Popullit kryen një inspektim pranë ambjenteve të ish-Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tiranë, ku këto familje priteshin të strehoheshin për një periudhë relativisht të gjatë kohore.

Nga inspektimi rezultoi se M.P.Ç.S.SH.B. kishte marrë tre godina të repartit të lartpërmendur, të cilat më parë kanë shërbyer si magazina dhe aktualisht, me qëllim ngritjen e një qendre të përkohshme për strehimin e familjeve nga komuniteti rom. Në to ishin bërë disa punime për t’i përshtatur si banesë për strehimin e familjeve rome, ato ishin suvatuar dhe lyer me gëlqere. Dy prej tyre do të shërbenin si banesa për fjetje e njëherazi për qëndrim ditor. Më poshtë po ju paraqesim disa nga konstatimet kryesore:

a.*Ambientet e banimit.* Godinat e destinuar për banesë kishin secila dy dhoma të mbyllura me disa dyer kompesate të cilat nuk kanë doreza, ndërsa përmasat e dritareve nuk ishin përshtatur për të siguruar ndriçim dhe ajrim të bollshëm natyral. Disa dritare nuk ishin mbyllur me xham, ndërsa ato që ishin të mbyllura nuk plotësonin kushtet e izolimit nga agjentet atmosferikë.

b.*Mobilimi i brendshëm* mungonte tërësisht, pasi dhomat nuk ishin të pajisura me karrike, tavolinë, dollapë, frigorifer dhe pajisje të nevojshme për gatim. Në fakt ishin vendosur vetëm disa krevatë dhe batanije të vjetra, aspak të përshtashme për të kryer funksionin e tyre. Dyshemeja ishte e shtruar vetëm me beton, ndërsa tavani ishte mbuluar me kompesatë e cila nuk siguronte hidroizolim pasi në disa vende dukeshin njolla myku.

c.*Rrjeti elektrik dhe hidraulik* në sipërfaqen e territorit në të cilin ndodhen godinat në fjalë, rezultoi të jetë jo funksional, për shkak se godinat objekt i inspektimit nuk furnizoheshin me energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu, në ambientet e banimit mungonin tërësisht ndriçuesit artificilal, si dhe rrjeti elektrik ishte i dëmtuar.

d. *Mjaft problematike paraqitej gjëndja e godinës së tualeteve të përbashkëta, pasi nuk ishin të pajisura me dyer dhe dritare, që në fakt aktualisht i bënë ato të papërdorshme. Ndërkohë që mbetet ende i paqartë fakti se si mund të vihen në funksionim këto ambiente, kur rezultoi të mungonte tërësisht sistemi i furnizimit me ujë. Gjithashtu mungonin pjesërisht pajisje hidrosanitare, si dhe nuk rezultoi të ishin instaluar dushet.*

e. Problematikë e përbashkët

Përgjatë inspektimit të kryer, mjaft problematike paraqitej gjëndja e ambienteve të përbashkëta përreth godinave. Në të gjithë sipërfaqen në fjalë, aktualisht janë krijuar pellgje me ujë dhe baltë, për shkak se nuk janë kryer punime për shtrimin apo drenazhimin e saj. Mungojnë tërësisht kanalizimet për disiplinimin e ujrave të shiut, si dhe pritet që në periudhën e verës të krijohet ambient tejet i papastër për shkak të pluhurave. Përfundimisht, nga inspektimi i kryer, arrihet në konkluzionin se, godinat e përshtaturore për ambiente banimi nuk konsiderohen funksionale dhe të pranueshme për banim sipas standarteve.

Pas inspektimit, dhe konstatimit të kushteve dhe standardeve të kësaj qendre, iu dergua Rekomandim **Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Z.Spiro Ksera**, për marrjen e masave lidhur me:

a. Hidroizolimimin e godinave të destinuara për ambiente banimi;

b. Vendosjen e dyerve dhe dritareve në të tre godinat;

c. Mobilimin e ambienteve me orenditë e nevojshme për të krijuar kushte normale për jetesë;

d. Funksionimin e sistemit elektrik dhe hidraulik;

e. Vendosjen e dusheve dhe të pajisjeve hidro-sanitare në tualetet e përbashkëta;

f. Sistemimi i ambienteve të përbashkëta përreth godinave.

Lidhur me këto rekomandime nuk kemi marrë ende asnjë përgjigje, për qëndrimin dhe veprimet e ndërmara nga MPCSSHB për zbatimin e tij.

Në vijim të ndjekjes dhe kontakteve nga afër që kemi patur me familjet e strehuara, me datë 18.05.2012 kemi inspektuar sërish ambientet e ish repartit ushtarak dhe kushteve të jetesës së të gjitha familjeve romë që janë akomoduar aty.

Problematikat e prezantuara nga kryefamiljaret e tyre kanë qënë të shumta. Instalimet në godinat për furnizimin me energji elektrike ekzistojnë, por në

drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, nevojitet një transformator i cili do të bëjë të mundur furnizimin me energji në ambjentet ku strehohen familjet. Për këtë problem, kryefamiljaret pretenduan se përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u kishin premtuar zgjidhje në një takim të bërë ndërmjet tyre, duke ofruar asistencën e një transformatori në këto kushte, por dhe ndihmesën për të gjitha problemet e tjera.

Faktikisht, situata prezantohej e tillë pasi asnjë masë nuk ishte marrë që prej këtij premtimi dhe kushtet e rënduara me të cilat duhet të përballonin jetesën këta persona po bëhej dramatike dita ditës.

Mungesa e energjisë dhe ujit sillte pasoja serioze jo vetëm për shendetin, kequshqyrjen, parametrat e pastërtisë së mjedisit përreth, por dhe në drejtim të plotësimit të aspektit kulturor e arsimor të fëmijëve në vijim.

Pavarësisht sa më sipër, Avokati i Popullit vijoi përpjekjet maksimale në drejtim të plotësimit të një jetese me kushte të përshtatshme për këta persona, të paktën për furnizimin me energji elektrike ujë të pijshëm dhe kanalizimin e ujërave të ndotura.

Mbi sa më sipër i rekomandua Drejtorit të Ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a:

“Marrjen e masave të nevojshme për furnizimin pa ndërprerje me ujë të pijshëm, të ambjentëve të Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tiranë, ku janë strehuar disa familje të komunitetit rom.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, u vumë në dijeni se Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve, nga verifikimi në vend i situatës në ambjentet e ish-Repartit Ushtarak në Sharrë, konsatoi se për momentin ishte e pamundur furnizimi i këtyre familjeve nga rrjeti i ujësjiellës, pasi në atë zonë nuk ka rrjet. UKT do të marrë masa për sistemimin e një depozite 5000 litra brenda ambjentit ku banojnë këto familje, furnizimi i së cilës përkohësisht do të behet me autobot nga shoqëria, derisa ky problem të marre zgjidhje definitive. Sipas përgjigjes së tyre, në vijim të investimeve të planifikuara nga UKT, është planifikuar dhe sistemimi e furnizimi me ujë i kësaj zone, gjë që do të bëjë të mundur edhe furnizimin e këtyre familjeve.

Gjatë inspektimit në qendrën ku ishin të sistemuar familjet rome, u konstatua se fëmijët e familjeve rome nuk frekuentonin shkollën. Nga intervistat e marra rezultoi se ishin 35 fëmijë, nga të cilët 20 të grupmoshave nga 1 deri në 5 vjeç

dhe pjesa tjetër (15 fëmijë) deri në moshën 14 vjeçare. Asnjë prej këtyre fëmijëve nuk ishin të regjistruar në shkolla, për të ndjekur arsimin 9-vjeçar.

Lëvizja e shpeshtë e pjesëtarëve të komunitetit rom, nga një vendbanim në tjetrin, ka bërë që ata të mos përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale shtetërore, e për më tepër fëmijët e këtij komuniteti, jo vetëm që kanë braktisur bankat e shkollave, por dhe shfrytëzohen në rrugë për të lypur e për punë të rëndomta. Mungesa e informacionit apo dhe neglizhenca e indiferentizmi i tyre, ka bërë që këta shtetas të mos figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre. Shumë familje rome janë vendosur në Tiranë prej vitesh dhe mosregjistrimi i tyre ka kufizuar aksesin në përfitimet ligjore dhe në këtë rast të regjistrimit të fëmijëve nëpër shkolla për të ndjekur arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar si dhe atë parashkollor.

Udhëzimi nr.6 datë 29.03.2006 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve rom që nuk janë të regjistruar në gjendjen civile” ka përcaktuar se fëmijët romë mund të regjistrohen në shkollë edhe pa çertifikata të lindjes.

Sa më lart, bazuar në parimin kushtetues se kushdo ka të drejten për arsimim, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i jemi drejtuar Drejtores së Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, me rekomandimin:

“Për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom, të vendosur pranë ish-repartit Ushtarak, Sharrë, Tiranë, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre.”

Në institucionin e Avokatit të Popullit nuk ka mbërritur asnjë përgjigje lidhur me qëndrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, ndaj këtij rekomandimi.

Avokati i Popullit ndjen keqardhje që qytetarët rom janë larguar para një muaji edhe nga ambientet e ish-repartit ushtarak në Sharrë dhe 6 prej tyre janë sistemuar pranë familjeve dhe të afërmeve të tyre në zonën e quajtur Bregu i Lumit në Tiranë, ndërkohë që dy prej tyre janë strehuar pranë ambjentëve të ish-ambasadës Jugosllave në Tiranë. Sipas familjeve rome të sistemuara në ambientet e ish-repartit ushtarak, largimi i tyre ka ardhur për shkak të dhunës nga banorët e zonës, të cilët pretendonin që reparti ushtarak, ishte pronë e tyre.

Lidhur me këtë ngjarje, Avokati i Popullit i ka nisur një letër Drejtorisë së Policisë së Tiranës për të filluar hetimin mbi shkaqet e dëbimit dhe dhunën që është ushtruar, sipas pretendimit të qytetarëve romë.

Të drejtat e komunitetit rom, janë pjesë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, monitormi i zbatimit të të cilave është pjesë e 12 prioriteteve të përcaktuara nga BE për Shqipërinë. Në rekomandimin 11 të BE, janë përcaktuar disa masa të cilat duhet të zbatohen për përmirësimin e të drejtave të minoritetit rom. Procesi i integritimit në BE, është një proces në të cilin Shqipëria duhet të tregojë vlerat e saj, dhe që meriton të jetë pjesë e familjes europiane. Në këtë kontekst të gjitha institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura kushtetuese kanë rolin dhe përgjegjësinë e tyre për të kontribuar në drejtim të përmirësimit të të drejtave të minoritetit rom, në përputhje me fushën e kompetencës së tyre, në plotësimin e detyrimeve që Shqipëria i janë vendosur gjatë këtij procesi nga institucionet e BE.

V. REKOMANDIME

Në përfundim të vlerësimeve të sipërpërmendura dhe të problematikave të konstatuara për minoritetin rom, gjatë veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën janar-qershor 2012, mendojmë se gjendja e respektimit të të drejtave dhe lirive të këtij komuniteti, ka nevojë për përmirësim.

Përsa i përket të drejtave të minoritetit rom, nuk ka ende të miratuar nga Këshilli i Ministrave një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit (të z. Pier Mirel) të dhjetorit 2011 “Për të drejtat e minoritetit rom”, ndërkohë që problematikat me të cilat ndeshen këta qytetarë janë të shumta si regjistrimi, strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i ndihmës ekonomike etj.

Nga analiza dhe vlerësimet e sipërpërmendura rekomandojmë:

1.Ndryshimin e ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), për të dhënë rregullime më të qarta dhe të sakta, për familjet e komunitetit rom. Për më tepër sugjerojmë përfshirjen si kategori prioritare brenda kushit social për përfitimin e strahimit.

2.Ndryshimin e akteve nënligjore të cilat parashikojnë kriteret dhe procedurat e regjistrimit dhe transferimit të gjendjes civile, duke hequr për familjet e komunitetit rom, parashikimet të cilat lidhen me pasjen në pronësi ose me qira të një banese.

3. Vazhdimin e përpjekjeve për funksionimin e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve Romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit Rom për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës.

4. Marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit Rom në programet e formimit profesional dhe punësimit në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

5. Marrjen e të gjitha masave të mundshme organizative për përgatitjen e vendstrehimeve apo vend-qendrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente, si pjestarë të komunitetit rom, personave endacakë apo të pastrehë dhe këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e pushtetit vendor, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve.

6. Të miratohet nga Këshilli i Ministrave një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit (të z. Pier Mirel) të dhjetorit 2011 “Për të drejtat e minoritetit rom”, si dhe të ndërmerren në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit masa ligjore dhe zbatuese për zgjidhjen e problematikave me të cilat ndeshen qytetarët romë, duke filluar nga regjistrimi, strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i ndihmës ekonomike etj.

Në përfundim dëshirojmë të theksojmë, që konkluzionet dhe rekomandimet e sipërcituara do të jenë objekt i vlerësimeve dhe analizave të mëtejshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile të cilë bashkëpunojnë me institucionin tonë.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligj, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara për minoritetin rom, në rekomandimin 11 të BE për Shqipërinë, duke dhënë edhe kontributin e tij lidhur me këto çështje.

